



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:917260
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05618669

CA.nr.2430/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.H, të cilin me autorizim e përfaqësoi avokati Q.R, kundër të paditurës KRMH “U” sh.a., të cilën e përfaqëson me autorizim E.N, për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, dukë vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, C.nr.168/23 e datës 28.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themelë ankesa e paditësit A.H ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë–Dega në Skenderaj–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.168/23 e datës 28.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor C.nr.168/23 e datës 28.12.2023, ka vendosur më sa vijon:

I. Hedhet poshtë si e pa lejuar padia e paditësit A.H, kundër të paditurës KRMH “U” sh.a., me të cilën ka kërkuar kthimin në vendin e punës si inkasant dhe kompensimin e pagave.

II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqituri i autorizuari i paditësit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar dhe aktvendimi i atakuar të priset.

E paditura nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 208 dhe 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë Dega në Skenderaj, me datën 05/03/2014, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, me kërkesë të përshkruar si në petitumin e padis.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padis së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, duke arsyetuar se nga provat e administruara u vërtetua fakti se paditësi në muajin prill të vitit 2012, ju është ndërprerë marrëdhënia e punës, ndërsa paditësi e ka ushtruar padinë me datën 05/03/2014 apo pasi ka kaluar afati ligjor i paraparë me datën 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Mbi këto arsye gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 143, nenin 391 par.f) dhe nenin 450 të LPK-së.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit i pranon si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me të meta thelbësore nga neni 182.2 të LPK-së, ndërsa i njëjti është marr në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës, përkatësisht neneve 78 dhe 79, lidhur me nenin 391 pika f) të LPK-së.

Duke e shqyrtuar aktvendimin në kufijtë e pretendimeve ankimore, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit në ankesë se aktvendimi i shkallës së parë është nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetim jo të saktë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si rezultat i të cilës është zbatuar gabimisht edhe e drejta materiale nga neni 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës dhe provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se paditësi e ka parashtruar padinë në gjykatë pas kalimit të afatit të përcaktuar ligjor. Në këtë drejtim, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në seancën e datës 30/10/2014 ka deklaruar se marrëdhënia e punës është ndërprerë në muajin Prill 2012, ndërsa me datë 05.03.2014, paditësi ka parashtruar padi në gjykatë me objekt të kontestit për kthimin në vendin e punës. Mirëpo e njëjta padi është hedhur si e pasafatshme nga gjykata e shkallës së parë, me arsyetim se e njëjta është ushtruar jashtë afatit ligjor. Në lidhje me këtë, drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë se nga ndërprerja e marrëdhënies së punës e deri me datën e paraqitjes së padisë në gjykatë kanë kaluar me shumë se 1 vit, me saktësisht padia është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor prej 45 ditësh (15+30), i cili afat është prekluziv, ku me kalimin e këtij afati humbet e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, andaj gjykata e shkallës së parë, me të drejtë e ka hedh poshtë si të palejuar, ngase e njëjta padi rezulton se është ushtruar jashtë afatit të përcaktuar me ligj. Kjo për faktin se me nenin 79 të Ligjit të Punës është përcaktuar decidivisht se: “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”. Mbi këtë bazë, rezulton se paditësit padinë në gjykatë e ka dorëzuar pas kalimit të afatit ligjor të cekur më lartë (*çështjen e llogaritjes së afatit për parashtrimin e padinë për mbrojtje gjyqësore në kontestet e punës e ka sqaruar Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin Rev. nr. 53/2013, datë 19.6.2013, i publikuar në Buletin e Praktikës Gjyqësore të vitit 2015*). Mirëpo, paditësi edhe pse ka pasur mundësi ligjore ti drejtohet me kohë gjykatës me padi për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, një gjë të tillë nuk e ka bërë, e si rezultat i kësaj aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë vlerësohet i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, i shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të paditësit, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Meqenëse gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, por edhe gjatë zhvillimit të procedurës ka vepruar sipas detyrës zyrtare konform dispozitave përkatëse ligjore që i referohen shqyrtimit të afatshmërisë së padisë (neni 391 pika f e LPK-së, lidhur me nenin 79 të Ligjit të Punës), atëherë gjykata e shkallës së dytë në zbatim të nenit 194, 195, 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CA.nr.2430/24, me datë 24.04.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku